



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të promovimit të Kosovës si vend atraktiv për investime dhe tregti, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe në bashkëpunim me partnerët: Oda Ekonomike e Zvicrës dhe Ambasada e Republikës së Kosovës në Zvicër, shpallë:

**Ftesë publike për shprehje të interesit për pjesëmarrje në Forumin
për Investime dhe Tregti që do të mbahet në Cyrih – Zvicër,
më 14 qershor 2017.**

Qëllimi i kësaj shpalljeje është që të ju mundësohet kompanive që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës që të shprehin interesin e tyre përmes aplikimit, për të marrë pjesë në këtë forum dhe për të takuar biznese nga Zvicra që do të marrin pjesë në forum.

Vetëm Aplikacionet e shprehjes së interesit të dërguara deri me datë **12 Maj 2017** dhe të plotësuara tërësisht do të mirren në shqyrtim për tu vlerësuar. Të gjitha fushat e zbrazëta duhet të plotësohen me informata të hollësishme dhe të sakta.

Më **11 Maj 2017**, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (në sallën e takimeve në KIESA) duke filluar nga ora 11:00 gjerë në ora 12:00, ekspertët e KIESA-së dhe partnerët me të cilët do të organizohet forumi do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen tuaj në forumin për investime dhe tregti. Kompanitë që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij aplikacioni, këshillohen gjithashtu që të marrin pjesë.

Pas përfundimit të shqyrtimit të aplikacioneve, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (në sallën e takimeve në KIESA), do të zhvillohet procesi i intervistimit të kompanive të cilat kanë shprehur interesim për pjesëmarrje në Forumin e Investimeve dhe Tregtisë, në Cyrih – Zvicër.

Të gjitha shpenzimet vetanake të përfaqësuesve të kompanive kosovare duke përfshirë transportin, akomodimin, ushqimin etj, do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e forumit.

Aplikimi: Kompanitë që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në forum duhet që aplikacionin e plotësuar ta dërgojnë **më së largu deri më 12 Maj 2017**, në e-mail adresën: **info.kiesa@rks-gov.net** ose në Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / KIESA, Rruga: Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, pa Nr. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Në bazë të Aplikacionit është hartuar edhe matrica për përzgjedhjen e kompanive, dhe nga rezultatet përfundimtare, do të përzgjidhen kompanitë me pikët më të larta.

Aplikacioni dhe informatat e nevojshme për shprehje të interesit mund të merren në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë / KIESA, dhe po ashtu mund të shkarkohen nga ueb faqja: **www.mti-ks.org**, ose të kërkohen në formën elektronike në e-mail adresën: **info.kiesa@rks-gov.net**